



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.45, datë 18.10.2023

**PËR**  
**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË**  
**TERRITORIT NR.39, DATË 27.07.2022 DHE DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të neneve 28, 29 dhe 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9, 9/1 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Maro-2017” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë shërbimi hotelier me 9 kate mbi tokë, me tarracë të shfrytëzueshme dhe 2 kate parkimi nëntokë dhe pishinë”, me vendndodhje në Golem, Bashkia Kavajë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Maro-2017” sh.p.k”.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, të miratuara me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 39 datë 27.07.2022 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Objekt shërbimi hotelier me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me vendndodhje në Golem, Bashkia Kavajë, me subjekt zhvillues shoqërinë “MARO-2017” sh.p.k.” zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për rishikimin e lejes së ndërtimit, miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit apo/dhe të shtyrjes së afatit, për objektin e përmendur në pikën 1, të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Kavajë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e

territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me Marrëveshjen përkatëse “Për Delegimin e Kompetencave” të nënshkruar mes Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Kryetarit të Bashkisë Kavajë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Kavajë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

**KRYETARI**

**EDA RAMA**




MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHYLLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 03/06 / 2024